



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 15. 03. 2010, në orën 16: 40

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

Nga takimi i Komisionit për Punë të Jashtme me delegacionin nga Republika e Maqedonisë.

Delegacioni i Republikës së Maqedonisë ishte në përbërje: Antonio Miloshovski, Ministër i Punëve të Jashtme i Republikës së Maqedonisë, Stojan Karajanov, Ambasador i Republikës së Maqedonisë në Kosovë, Dejan Kostadinov Petrov, drejtor për Marrëdhënie Bilaterale, Kristina Kozovska Gavrilova, këshilltare, Driton Dema, bashkëpunëtor dhe Ismet Bitiq, përkthyes.

Në takim nga Komisioni morën pjesë: Sabri Hamiti, Enis Kervan, Ramë Buja, Ibrahim Gashi, Ardian Gjini, dhe Slobodan Petroviq.

Në takim ishte i pranishëm edhe Skënder Durmishi, i ngarkuar me punë në Ambasadën e Kosovës në Shkup.

Munguan: Xhavit Haliti, Lutfi Haziri dhe Nexhat Daci.

Të pranishëm nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. Takimi me delegacionin nga Republika e Maqedonisë

Sabri Hamiti – Shprehi kënaqësinë për praninë e delegacionit të Republikës së Maqedonisë, të kryesuar nga Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Maqedonisë, Antonio Miloshovski, në takim me Komisionin për Punë të Jashtme, që të bisedohet për marrëdhëniet domosdoshmërisht të mira ndërmjet dy shteteve.

Antonio Miloshovski - Ndërmjet nesh është një perspektivë e madhe për bashkëpunim në shumë fusha, po ashtu ekziston gatishmëria e Qeverisë për ndërmarrjen e hapave që të lehtësohet komunikimi ndërmjet dy vendeve. Me procesin e hapjes së ambasadave të të dy vendeve është arritur niveli më i lartë politik i marrëdhënieve reciproke, i cili duhet ta zhvillojë bashkëpunimin më të fuqishëm në nivelin ekonomik, në energjetikë, në transport e komunikime dhe në nivel të bashkëpunimit kulturor ndërmjet qytetarëve tanë. Objektivi i Maqedonisë është që të kontribuojë në stabilitetin e rajonit, që me vendimin për njohjen e pavarësisë së Kosovës është dhënë ky kontribut. Çështja e hapur e

demarkacionit të kufirit, është përmyllur që në aspektin bilateral dhe ndërkombëtar tregon për interesa dhe ardhmëri të përbashkët të dy shteteve. Republika e Maqedonisë do të angazhohet që në institucionet evropiane, të rekomandojë se procesi i liberalizimit të vizave duhet të vazhdojë me shtetet e tjera në rajon, edhe për Kosovën. Në aspektin e politikës së jashtme të Maqedonisë ndaj rajonit nuk ka vend për ndarje dhe kufij të rinj, por sfida për një rajon pa kufij, pjesë e familjes evropiane.

Ndërtimi i autostradës Prishtinë - Shkup do të mundësojë një komunikim më të lehtë ndërmjet dy vendeve, e po ashtu është nevojë përbashkët e Kosovës dhe Maqedonisë të zhvillojnë një partneritet strategjik lidhur me energjetikën. Akti i njohjes së pavarësisë i cili është bërë në koordinim me Malin e Zi, nuk ka qenë hap i lehtë, por ne e kemi konsideruar njohje të një realiteti.

Republika e Maqedonisë do të jetë kryesuese e Këshillit të Evropës në Strasburg, nga muaji maj deri në nëntor të këtij viti, dhe në këtë cilësi jemi të gatshëm të ofrojmë shërbime dhe këshilla nëse për këtë do të tregohet nevoja nga pala kosovare. Maqedonia më vëmendje pret mendimin e GJND - së rreth pavarësisë së Kosovës, ndërsa vendimi për njohjen do të mbetet i pandryshuar dhe marrëdhëniet diplomatike, ndërmjet nesh do të thellohen.

Sabri Hamiti - Marrëdhëniet ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës po hyjnë në nivele institucionale, të cilat do të zhvillohen edhe më tej, sepse janë vende të lidhura historikisht dhe gjeografikisht.

Maqedonia gjendet në një fazë të integritimeve evropiane, përvoja e të cilës është e nevojshme për shtetin tonë. Është i nevojshëm edhe intensifikimi i marrëdhënieve në mes të komisioneve homologe që shpresojmë se së shpejti do të rritet bashkëpunimi. Planifikojmë të organizojmë një konferencë me pjesëmarrje të komisioneve homologe të vendeve të rajonit rreth perspektivave të integritimeve evropiane, të cilën shpresojmë se Komisioni homolog i Maqedonisë do ta përkrahë.

Ramë Buja - Maqedonia është një shtet fqinj, me të cilin kemi shumë interesa të përbashkëta dhe në të ardhmen, mund ta begatojmë dhe forcojmë miqësinë edhe më tepër ndërmjet dy shteteve.

Ardian Gjini - Për përfaqësuesit e tij tha se është me rëndësi që Kosova t' i zhvillojë edhe më tepër marrëdhëniet me Maqedoninë. I gëzohemi përparimit të Maqedonisë dhe i dëshirojmë që shumë shpejt të jetë anëtare e NATO - s dhe ta përshpejtoj hapin drejt integritimit evropian, që do të ishte edhe një ndihmesë për Kosovën. Bashkëpunimi me Maqedoninë, mund të thellohet në shumë aspekte.

Ibrahim Gashi - Ne jemi mirënjohës për vendimin të cilin e ka marrë Maqedonia për njohjen e Kosovës në kohën e duhur dhe paragjykimet që kanë mundur të ekzistojnë janë kthyer në simpati ndërmjet dy shteteve. Është i rëndësishëm ndikimi i Maqedonisë për atë që ka mundësi në procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën, sepse kjo çështje ndikon edhe në procesin e shtetndërtimit të Kosovës. Liberalizimi i vizave në Serbi po ndikon në komunitetin serb dhe po e pengon politikën e integritimit të serbëve në institucionet e Kosovës, që është politikë e brendshme shtetit të Kosovës.

Enis Kervan - Në diskutimin e tij e falënderoi shtetin e Maqedonisë për trajtimin e njëjtë të studentëve kosovarë që studiojnë në Maqedoni, pa kurrfarë dallimi nga studentët maqedonë.

Slobodan Petroviq - I dëshiroi mirëseardhje delegacionit nga Maqedonia me dëshirën që kontaktet të vazhdojnë të thellohen në të ardhmen, po ashtu falënderoi bartësit e institucioneve që kanë dhënë kontributin e tyre për angazhimin dhe për mbështetjen e komunitetit serb. Partia SLS është e përfaqësuar në Kuvend dhe prioritet i saj janë marrëdhëniet reale në raport me komunitetin shqiptar.

Në periudhën katërvjeçare kjo parti ka punuar shumë dhe e ka ndihmuar komunitetin serb me ndërtimin e shtëpive dhe me infrastrukturën tjetër përcjellëse. Në zgjedhjet e fundit lokale komuniteti serb ka marrë pjesë diku rreth 40 % dhe SLS promovon një politikë reale dhe evropiane.

Sabri Hamiti - Shtroi kërkesën për kontakte sa më të shpejta me Kuvendin e Maqedonisë dhe mundësinë për formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Maqedonisë dhe Kuvendit të Kosovës. Republika e Kosovës pret ndihmën e Republikës së Maqedonisë për komunikimet evropiane.

Antonio Miloshevski - Lidhur me konferencën me karakter rajoni, e cila planifikohet të organizohet në Prishtinë, tha se do ta njoftojë kryetaren e Komisionit për Punë të Jashtme që ta mbështesë mbajtjen e këtij takimi. Po ashtu njoftoi edhe për iniciativën maqedone për hapjen edhe të dy pikave kufitare, në Tanushë -Debëllde dhe Stanqiq - Bellanoc dhe për investimin e shoqërisë maqedone, që të gjithë qytetarëve të vet t'ju afrojnë arsimimin në gjuhën amtare.

Mbledhja përfundoi në orën 17: 40.

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetje të Komisionit